REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 644/20
Date/Datum. 10.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A.nr.644/20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Grupit të OE **"Goldberg Industries L.L.C." - Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, të iniciuar nga AK / Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a., Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 09 SHTATOR 2020 mori këtë :

VENDIM

I. **Hedhet si e jashtë afatshme** ankesa e OE **"Goldberg Industries L.L.C." - Prishtinë**, me nr. të protokolli: 644/20, e datës: 09 SHTATOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të

brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, të iniciuar nga AK / Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a.

II. **I LEJOHET** Autoritetit Kontraktues – Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a., që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, të iniciuar nga AK / Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a., përkitazi me këtë ankesë, (nëse nuk ka ankesë tjetër).

III. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Më datën 08 SHTATOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE **"Goldberg Industries L.L.C." - Prishtinë**, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokolli. 644/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, të iniciuar nga AK / Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE **"Goldberg Industries L.L.C." – Prishtinë**, me nr. të protokolli. 644/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, të iniciuar nga AK / Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a. dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si dhe në platformën e-prokurimi kjo ankesë rezulton të jetë e pa lejuar.

Nga se Autoriteti Kontraktues (AK) Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a. për aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe instalimi i softuerit sistemi ERP - Ritender"**, me numër të prokurimit AP: **IL-20-4215-1-2-1** dhe numër të brendshëm: **IL-20-019-1-2-1**, Njoftimin për kontratë fillimisht e ka publikuar me dt.06.08.2020.
Kundër Njoftimit të lartëcekur Operatori Ekonomik (OE) ankues ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim të vendimit të AK-së me dt. 26.08.2020.
AK me dt.28.08.2020, e ka njoftuar OE ankues me vendim për aprovim si të bazuar të kërkesës për Rishqyrtim dhe ka sqaruar se AK ka bere përmirësimin e dosjes se tenderit përmes B54 formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimin e publikuar do te ngarkohet në e-prokurim.

Kundër vendimit te AK-së të datës 28.08.2020, te kërkesës për rishqyrtim OE ankues ne mënyrë elektronike ka parashtruar ankesë në OSHP me datën: 07.09.2020 në ora 16:08 minuta, ankesë e cila është protokolluar te nesërmen me datën 08.09.2020,sipas orarit zyrtare te punës.

Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pas parasysh faktin se AK e ka njoftuar OE ankues me vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim me dt.28.08.2020, afati ligjor sipas LPP-së , për parashtrim të ankesës në OSHP ka filluar te rrjedh nga data 29.08.2020, nga ora 08:00 deri në ora 16:00, dhe ka përfunduar me datën 07.09.2020 në ora 16:00 (duke pasur parasysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE : **"Goldberg Industries L.L.C." - Prishtinë,** ka humbur afatin ligjor për parashtrim të ankese në OSHP andaj ankesa e dorëzuar në mënyrë elektronike me datën 07.09.2020, në ora 16:08 minuata dhe e protokolluar me datën 08.09.2020 me numër te protokollit 644/20, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e **pa afatshme.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :
Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në ora16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të dielë ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si me lartë OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: **"Goldberg Industries L.L.C." – Prishtinë, në mënyrë elektronike me datën 07.09.2020 ne ora 16:08 minuta dhe e protokolluar me datën 08.09.2020 me numër te protokollit 644/20** , hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës

për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e jashtafatshme dhe nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" sh.a.

1x1 OE "Goldberg Industries L.L.C." - Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së